



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1701/1 Prot.

Tiranë, më 23 . 12 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 321, Datë 23 . 12 . 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 20, datë 07.04.2017, e bërë nga z. D.D, kundër Avokaturës së Shtetit (ASH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjuhës” dhe “gjendjes arsimore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaron se: “Në datë 10.03.2017, me anë të një kërkesë i është drejtuar Avokaturës së Shtetit për të kërkuar informacion publik në gjuhën shqipe për shkresën nr. 507/14 datë 24.05.2013, të dërguar nga Avokatura e Shtetit për Zyrën e Ekzekutimit të Vendimeve, në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut për çështjet Driza dhe Manushaqe Puto. Me anë të e-mail-it datë 21.03.2017, Avokatura e Shtetit ka refuzuar dhënien e shkresës në gjuhën shqipe, me arsyetimin se, institucioni nuk e ka në zotërim informacionin e kërkuar në gjuhën shqipe dhe se kërkesa për përkthimin e këtij dokumentacioni nga Avokatura e Shtetit nuk parashikohet në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në ligjin nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit””.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe vënien në dispozicion të shkresës së sipërcituar në gjuhën shqipe.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

Shtetasi D.D me ankesën nr. 17, datë 15.02.2016, i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në të cilën ka pretenduar diskriminim për shkak të *“gjuhës”* dhe *“gjendjes*

<sup>1</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

*arsimore*” nga ana e Avokaturës së Shtetit, për mosvënien në dispozicion në gjuhën shqipe të një shkrese, nga ana e institucionit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fund të procedurës së hetimit ka dalë me Vendimin nr. 205, datë 30.12.2016, me anë të të cilit ka vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të shtetasit D.D, për shkak të gjuhës, nga ana e Avokaturës së Shtetit.*
2. *Rekomandohet që Avokatura e Shtetit, sa herë të ketë kërkesa, të marrë masa për vënien në dispozicion të shtetasve të informacionit që disponon në gjuhën shqipe.*

Duke mos rënë dakord me vendimin e Komisionerit, Avokatura e Shtetit me anë të Kërkesë Padisë, Nr. 1793 akti, datë 14.02.2017, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka kërkuar shfuqizimin e Vendimit nr. 205, datë 30.12.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si të paligjshëm dhe në kundërshtim të hapur me faktet dhe rrethanat e çështjes.

Theksojmë faktin se të njëjtat kërkesa, rrethana dhe shkaqe janë paraqitur dhe në ankesën e dytë, nr. 20, datë 07.04.2017, të ankuesit D.D kundër Avokaturës së Shtetit dhe vlerësimi mbi ligjshmërinë e Vendimit nr. 205, datë 30.12.2016, të Komisionerit, po gjykohet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Përsa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në mbështetje të nenit 66, pika 1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Vendimin nr. 39, datë 30.05.2017, ka pezulluar shqyrtimin e ankesës nr. 20, datë 07.04.2017, të z. D.D, deri në momentin që Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë, për Vendimin nr. 205, datë 30.12.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në vijim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin nr. 1702, datë 25.04.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesë padisë.*
- *Shfuqizimin e Vendimit nr. 205, datë 30.12.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.*

Gjykata Administrative e Apelit, me Vendimin nr. 380, datë 21.03.2024, të komunikuar pranë Komisionerit me shkresën nr. 14969, datë 15.10.2024, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1702, datë 25.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

Në këto kushte, pas njohjes me aktet e mësipërme shkresore (vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit), lidhur me vënien në dispozicion të të interesuarit të materialin në gjuhën Shqipe nga ana e Avokaturës së Shtetit, Komisioneri me Vendimin nr. 300, datë 04.12.2024, ka vendosur ndërprerjen e pezullimit dhe çeljen e procedurës së shqyrtimit të ankesës.

Gjykata Administrative e Apelit në Vendimin nr. 380, datë 21.03.2024, në mes të tjerash, ka arsyetuar si më poshtë:

*“Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore rezulton e provuar se pranë paditësit Avokatura e Shtetit, janë paraqitur dy kërkesa nga z. D.D, respektivisht në datat 15.01.2016 dhe 29.01.2016.*

*Për secilën prej tyre z. D.D ka marrë përgjigje. Në kërkesën e datës 29.01.2016, ku z. D kërkon që informacioni i kërkuar të përcillet në gjuhën shqipe është sqaruar se dokumenti i kërkuar nga z. D, i është vënë në dispozicion në gjuhën angleze, pasi i tillë është përgatitur dhe i tillë disponohet nga vetë Avokatura. Gjithashtu ai sqaron se vënia në dispozicion e dokumentit në gjuhën angleze nuk ka patur qëllim diskriminimin e z. D, e as të personave të tjerë të panjohur prej tij. Referuar ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, neni 5 i tij ku janë përcaktuar funksionet e avokatit të shtetit, rezulton se nuk është detyrë funksionale e avokaturës, përkthimi i dokumentacionit në gjuhë të huaj, përkatësisht atë angleze, në rastin konkret.*

*Në këto kushte, provohet se paditësi nuk është në kushtet e diskriminimit të tërthortë, pasi referuar nenit 3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk provohet që veprimet e paditësit të kenë vënë z. D apo persona të tjerë në kushte jo të favorshme, e diskriminuese për shkak të gjuhës, pasi paditësi ka vënë në dispozicion të z. D, dokumentin e kërkuar në kushtet që e dispononte edhe vetë.*

*Në gjykimin në shkallë të parë ka rezultuar e provuar se procedura e publikimit të dokumenteve, të cilat hartohen nga institucioni i Avokatit të Shtetit, është e njëjtë me procedurën e ndjekur nga të gjitha institucionet e tjera në Republikën e Shqipërisë, në respektim të parimeve të së drejtës, të Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Në rastet kur dokumentacioni i përgatitur në gjuhë të huaj, kërkohet nga persona të interesuar apo institucione, u vihet në dispozicion, në rastet kur nuk shkelet parimi i konfidencialitetit, në gjuhën që disponohet.*

*Po kështu, ka rezultuar e provuar se institucioni i Avokatit të Shtetit, nuk ka pasur raste të tjera, që të ketë vënë në dispozicion të shtetasve shqiptarë dokumentacion, në gjuhën shqipe. Ky dokumentacion është përgatitur në gjuhë të huaj, në respektim të detyrimeve që Shteti Shqiptar ka si anëtar i organizmave ndërkombëtare.*

*Rezulton se shtetasi D.D i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit, “Planin e veprimit për ekutimin e vendimit pilot të Gjykatës së Strasburgut, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë””,*

aplikimet 604/07, 43628/07, 46684/07, 34770/09, përfundimtar në datën 17.12.2012. Hartimi i këtij plan veprimi i është kërkuar Autoriteteve Shqiptare, në mbledhjen 1243, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, datë 8-9 dhjetor 2015.

Planet e veprimit/raportit, janë dokumente të përgatitur nga autoritetet shqiptare, me qëllim ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Planet e veprimit përmbajnë raportimin e qeverisë, në lidhje me ekzekutimin e masave individuale dhe masave të përgjithshme, të përcaktuara në vendimet respektive. Hartimi dhe zbatimi i tyre është detyrim i shtetit shqiptar, i marrë përsipër me aderimin si anëtar i Këshillit të Evropës dhe ratifikimin e Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut. Planet e veprimit hartohen, për çdo vendim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilin ka detyrime për shtetin shqiptar dhe jo vetëm për rastin konkret. Shteti Shqiptar ka detyrim të raportojë çdo 6 muaj në lidhje me ecurinë e planeve të veprimit në Komitetin e Ministrave. Planet e veprimit/raportimit i njoftohen Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, nëpërmjet Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, i cili mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane si dhe respektimin e detyrimeve të marra përsipër nga shteti shqiptar, me aderimin në këtë organizatë dhe nënshkrimin e ratifikimin e Konventës Evropiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut.

Komiteti i Ministrave, i publikon planet e veprimit/raportimit në faqen e tij zyrtare, e cila është e aksesueshme nga cilido dhe, të cilën pala paditëse, ia ka rekomanduar z. D, si një zgjidhje të shpejtë dhe efektive. Rezulton se Shoqatat dhe institucionet shqiptare, të cilat kanë paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese për Ligjin e Pronave, i kanë marrë informacionet, në lidhje me planet e veprimit/raportimit si dhe komunikimet e autoriteteve shqiptare me Komitetin e Ministrave, në gjuhën angleze, në faqen e Komitetit të Ministrave. Po kështu kanë vepruar dhe disa shoqata, të cilat kanë paraqitur dhe ankimet e tyre pranë Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, në gjuhën angleze.

Gjuhët zyrtare të përdorur në komunikimin me Komitetin e Ministrave, të Këshillit të Evropës janë anglisht dhe frëngjisht.

Kështu, Neni 59 i Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, “Nënshkrimi dhe ratifikimi”, në pikën 5 të tij parashikon: “..Bërë në Romë, më 4 Nëntor 1950, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëllor autentike, në një kopje të vetme, e cila dorëzohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon kopje të njësuara me origjinalin secilit nënshkrues”.

Neni 12 i Statutit të Këshillit të Ministrave, i cili përfshin dhe mbledhjet e tij për të Drejtat e Njeriut, parashikon se: “Gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës janë anglisht dhe frëngjisht. Rregullat e Procedurës së Komitetit të Ministrave dhe të Kuvendit Konsultativ, do të përcaktojnë në çfarë rrethanash dhe në çfarë kushtesh gjuhë të tjera mund të përdoren”.

Gjithashtu, në “Metodat dhe rregullat e punës të Komitetit të Ministrave, në nenin 8 “Gjuhët” parashikohet që “7. Anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhët zyrtare, në përputhje me nenin 12 të

*Statutit. 2. Delegatët mund të flasin në ndonjë gjuhë tjetër, por në këtë rast ata vetë duhet të ofrojnë përkthimin në një nga gjuhët zyrtare”.*

*Gjuha e përdorur në komunikimet e Shteteve Palë, aplikantëve, Organizatave Jofitimprurese dhe Joqeveritare, apo çdo personi tjetër të interesuar, me institucionet e Këshillit të Evropës është gjuha angleze ose ajo franceze.*

*Shqipëria si Shtet Palë, në kuadër të këtyre parashikimeve ligjore, të gjitha raportimet, përcjelljen e informacionit si dhe komunikimet me këtë institucion, është e detyruar ti kryejë në një nga dy gjuhët zyrtare të njohura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.*

*Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se Avokatura e Shtetit me veprimet e saj nuk ndodhet përpara rasteve të përcaktuara nga nenet 1, 3/1 dhe 7 të ligjit nr. 10221/2010.*

*Po kështu, në bazë të pikës 2, të nenit 2, dhe nenit 14, Pika 2 shkronja “b”, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, një kopje e plotë e “informacionit publik” të kërkuar, që disponohej në arkivat e Avokatura e Shtetit, i është dërguar kërkuarit D.D. Informacioni shtesë i kërkuar, i njëjti dokumentacion, por në gjuhën shqipe, nuk ka ekzistuar ndonjëherë dhe nuk ka përbërë ndonjëherë “Informacion publik”, në kuptim të pikës 2, të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.*

*Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka arsyetuar se në zgjidhjen e drejtë të çështjes, vlerëson se në themel të diskriminimit, në kuptimin që i japin diskriminimit ligji, të gjithë konventat, legjislacionet dhe fjalorët e botës, është trajtimi i pabarabartë i subjekteve, ose siç është parashikuar në ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”: “do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, ... në raport me një tjetër person ose grup personash”.*

*Në fjalorin zyrtar “Shqip-Shqip” fjala “diskriminoj” shpjegohet: “E dalloj dikë nga të tjerët dhe e trajtoj keq, duke mos e quajtur të barabartë me ta dhe duke ia kufizuar a duke ia mohuar fare të drejtat që i takojnë”.*

*Në “Black Law Dictionary” koncepti diskriminim shpjegohet “Trajtimi i një personi ose grupi të veçantë, ndryshe nga sa trajtoni të tjerët, për shkak të ngjyrës, seksit, orientimit seksual, etj”.*

*Në nenin 14 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” është parashikuar: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.*

*Në gjykim rezultoi e provuar se informacioni i disponuar nga paditësi në këtë gjykim, i është dhënë zotit D.D, dhe ky fakt pranohet prej tij dhe nga Komisioneri.*

*Sipas përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, i akteve apo komunikimeve me/për, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për zotën D.D. apo për cilindo shtetas shqiptar apo të huaj, nuk është parashikuar në ligj, të bëhet nga Avokatura e Shtetit”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pabarabartë.**

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “*krahasuesi*”. Në rastet dhe kushtet kur ky “*krahasues*” mungon, vlerësohet nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Avokaturës së Shtetit.

*Nga këqyrja e dokumentacionit rezulton se:*

Me e-mail-in datë 10.03.2017, subjekti ankues me anë të një kërkesë i është drejtuar Avokaturës së Shtetit për të kërkuar informacion publik në gjuhën shqipe për shkresën nr. 507/14 datë 24.05.2013, të dërguar nga Avokatura e Shtetit për Zyrën e Ekzekutimit të Vendimeve, në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut për çështjet Driza dhe Manushaqe Puto.

Me e-mail-in datë 21.03.2017, Avokatura e Shtetit i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e informuar në mes të tjerash se: “*Institucioni nuk e ka në zotërim informacionin e kërkuar “Shkresën nr. 507/14, datë 24.05.2013, në gjuhën shqipe”. Kërkesa juaj për përkthimin e këtij dokumentacioni nga Avokatura e Shtetit, nuk parashikohet në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nuk është e shoqëruar me bazë tjetër ligjore.*

*Në ligjin nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit” nuk është parashikuar përkthimi prej Avokaturës së Shtetit, për publikun, i akteve që ndodhen në arkivat e saj. Ky shërbim për publikun mund të kryhet dhe kryhet nga përkthyes të licencuar”.*

Në nenin 5 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, janë parashikuar funksionet e Avokatit të Shtetit, në të cilën janë përcaktuar se:

*“1. Avokatura e Shtetit kryen funksionet e mëposhtme:*

*a) ofron shërbim këshillimor për veprimtarinë juridike të personave juridikë të parashikuar në këtë nen, veçanërisht për lidhjen e kontratave, të cilat parashikojnë efekte financiare për shtetin;*

*b) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të*

veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës;

c) u ofron asistencë juridike njërive të qeverisjes vendore, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme, të lidhura për këtë qëllim, ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore;

ç) bashkërendon punën me prokurorinë për mbrojtjen, në gjykim, të interesave të shtetit për çështjet civile, zgjidhja e të cilave bëhet gjatë një procesi penal;

d) përcakton rregulla për unifikimin e praktikave dhe formulimin e kritereve të përgjithshme të asistencës juridike të shtetit;

dh) ndërmjetëson për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike;

e) ka të drejtën e nisjes së veprimeve ligjore, me qëllim për të shfuqizuar aktet juridike dhe kontratat administrative, si edhe për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në pajtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin procedural dhe në këtë ligj, me autorizim paraprak të organit administrativ të interesuar, me përjashtim të rasteve të urgjencës;

ë) ka të drejtë të ngrejë padi, me objekt shpërblimin e dëmit të shkaktuar interesave pasurorë të shtetit, me autorizimin e organit shtetëror përkatës, me përjashtim të rasteve të urgjencës.

f) mbi bazën e kërkesës së Kryeministrit, jep mendim për projektakte që lidhen me veprimtarinë e organeve të administratës publike”.

Nërsa në Kreun V/1, të ligjit sipërcituar, “Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, neni 19/2, “Fillimi i procedurave të ekzekutimit”, parashikohet se:

“1. Me marrjen dijëni mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së”.

Neni 12 të Statutit të Këshillit i Evropës<sup>2</sup>, parashikohet se: “Gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës janë anglisht dhe frëngjisht. Rregullat e Procedurës së Komitetit të Ministrave dhe të Kuvendit Konsultativ, do të përcaktojnë në çfarë rrethanash dhe në çfarë kushtesh gjuhë të tjera mund të përdoren”.

<sup>2</sup> Statute of the Council of Europe, European Treaty Series-No.1, London, 5.V.1949, <https://rm.coe.int/1680935bd0>



Referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se Avokatura e Shtetit, në përmbushje të funksioneve të saj, nuk ka të parashikuar shërbimin e përkthimit të dokumenteve që i disponon në gjuhë të huaja. Gjithashtu dhe për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, institucioni i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë për përkthim dhe certifikim të këtyre vendimeve.

Gjithashtu, referuar Vendimit nr. 380, datë 21.03.2024, të Gjykatës së Apelit, Komisioneri vlerëson se çështja e vendosjes në dispozicion të ankuesit të dokumentit në gjuhën shqipe, ndërkohë që dokumenti disponohet në gjuhën angleze, mes subjektit ankues dhe Avokaturës së Shtetit, i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe Gjykata ka marrë një vendim të formës së prerë për këtë çështje. Në këtë rast, Komisioneri çmon të theksojë faktin se të njëjtat kërkesa, rrethana dhe shkaqe janë paraqitur dhe në ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se nuk ka tagër të vlerësojë vendimin e Gjykatës, të sipërcituar, por e merr të mirëqenë atë, i cili ka vlerësuar se subjekti ankues nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Avokaturës së Shtetit.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e subjektit ndaj të cilit ka paraqitur ankesën.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Avokaturës së Shtetit, për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe

për rrjedhojë nuk provohet se Avokatura e Shtetit, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. D.D, për shkak të gjuhës dhe gjendjes arsimore, nga ana e Avokaturës së Shtetit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**